



Republika e Kosovës

Republic of Kosovo - Republika Kosova
Qeveria – Government -Vlada

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation /
Ministarstvo Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija

KOMISIONI I PËRBASHKËT I SHQIPËRISË DHE KOSOVËS PËR MIRATIMIN E TEKSTEVE MËSIMORE TË PËRBASHKËTA PËR DIASPORËN

THIRRJE PËR APLIKIM NË KONKURSIN E TEKSTIT MËSIMOR PËR DIASPORËN, NIVELI III

Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve Mësimore të Përbashkëta për Diasporën shpall thirrjen për aplikim në konkursin e tekstit mësimor për mësimin plotësues të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe mërgatë, **“Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare”, niveli III.**

1. Teksti mësimor hartohet në përputhje me:
 - a) Kurrikulën e përbashkët të mëimit plotësues të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe mërgatë, Tiranë – Prishtinë, miratuar në prill 2018.
 - b) Paketën e dokumenteve të miratuara me Urdhrin/Vendimin e përbashkët, nr. 21, datë 13.01.2023, *“Për miratimin e paketës së dokumenteve për procedurën e zhvillimit të konkursit të teksteve mësimore për diasporën, niveli II dhe niveli III”.*
2. Ftohen të aplikojnë shtëpitë botuese që përmbushin kriteret e përcaktuara në paketën e dokumenteve të miratuara me Urdhrin/Vendimin nr. 21, datë 13.01.2023.
3. Subjekti aplikues paraqitet gjatë orarit zyrtar të punës të Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve Mësimore të Përbashkëta për Diasporën për të dorëzuar dokumentacionin ligjor dhe teknik, si dhe dorëshkrimin e tekstit mësimor në datat **23–24 tetor 2024**, në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në Prishtinë ose në Qendrën e Botimeve për Diasporën në Tiranë.

4. Aplikimet që nuk janë në përputhje me përcaktimet e paketës së dokumenteve për procedurën e zhvillimit të konkursit të teksteve mësimore për diasporën apo të paraqitura jashtë afateve të përcaktuara më sipër, do të refuzohen.
5. Miratimi i listës së dorëshkrimeve të teksteve të renditura sipas vlerësimeve bëhet në muajin **nëntor 2024**.
6. Miratimi dhe shpallja e tekstit mësimor fitues bëhet në muajin **dhjetor 2024**.
7. Subjektet i paraqesin ankimet e tyre sipas afateve të përcaktuara në paketën e dokumenteve të miratuara me Urdhrin/Vendimin nr. 21, datë 13.01.2023.
8. Për çdo pyetje, lutemi na kontaktoni në adresën (info@qbd.gov.al).
9. Për shkarkimin e materialeve të nevojshme për aplikim dhe për hartimin e teksteve mësimore, **klikoni në linkun:**

<https://drive.google.com/drive/folders/1-0vaEdXJPmC4z8TCYMWaFqh4hO03a66R?usp=sharing>